



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## E K T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 22.10.2024, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Faton Marolli, Adnan Ajeti.

Mungoi: Trieria Kasumi Berisha.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë;

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Jehona Lushaku Sadriu,
  - a) shqyrtimi i raportit të vizitës në shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë;
  - b) Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelina Sahiti,
    - a) Raport mbi numrin e familjeve të komuniteteve joshumicë rom, ashkali, turk, boshnjak, serb dhe goran, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike;
    - b) Shqyrtimi dhe miratimi i listës së familjeve të komuniteteve joshumicë për dru zjarri.
4. Formimi i Komisionit për vizitë Zyrës për çështje të komuniteteve pranë Kabinetit të Kryeministrit, si dhe caktimi i takimit përmes ZKKK-ës;
  - a) Familjet të cilave ju është më e nevojshme ndihma për ndërtimin;
  - b) Ndihmë familjeve me nevoja sociale të komuniteteve joshumicë të Komunës së Prishtinës;
  - c) etj.
5. Raporti i ZKKK-ës për muajin Shtator 2024;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
7. Të ndryshme.

Faqe 1 nga 6